



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK
TIRANË

Rruga: “Aleksandër Moisiu”, Nr 80, Tiranë, Albania.

Tel: +355 42374756, Fax 355 42370058

DEPARTAMENTI I KONTROLLIT TË SËMUNDJEVE INFEKTIVE

ECURIA E SURVEJANCËS SINDROMIKE "ALERT" PËR PERIUdhËN
12 MARS – 18 MARS 2012
(JAVA 11)

Për këtë periudhë, kanë raportuar 36 rrethe ose 100% (=36/36) e tyre

22 rrethe ose 60% (=22/36) e tyre kanë raportuar me telefon, faks, postë:

BERAT, DELVINË, ELBASAN, GJIROKASTËR, KORÇË, KRUIJË, KUÇOVË, LEZHË, PËRMET, SARANDË, DIBËR, GRAMSH, HAS, KAVAJË, KOLONJË, KURBIN, MALLAKASTËR, M. MADHE, MIRDITË, PEQIN, SKRAPAR, TROPOJË.

14 rrethe ose 40% (=14/36) e tyre kanë raportuar me postë elektronike:

BULQIZË, DEVOLL, DURRËS, FIER, KUKËS, LIBRAZHD, LUSHNJE, MAT, POGRADEC, PUKË, SHKODËR, TEPELENË, TIRANË, VLORË.

Pa raportim brenda afatit, asnjë rreth ose 0% (=0/36) e tyre:

NUMRI TOTAL I RASTEVE TË SINDROMAVE TË SURVEJANCËS “ALERT” NË JAVËN 11

	JAVA 11
DIARRE PA GJAK	1.009
DIARRE ME GJAK	1
INF. RESP. TE SIPERME	8.175
INF. RESP. TE POSHTEME	4.667
RASH ME TEMPERATURE	2
VERDHEZA	0
HEMORRAGJI ME TEMPERATURE	0
SUSPEKT MENINGITIS	0
ETHE TE PASHPJEGUESHME	2
Numri i Njësive Raportuese	395
% e Njësive Raportuese	94% (395/420)

Diarre me gjak

Rasti është raportuar nga rrethi i Krujës me diagnozen “Shigelozë” dhe është hospitalizuar në spitalin Infektiv QSUT. Në vatër janë marrë masat e kontrollit dhe të parandalimit.

Rash me temperaturë


Rastet janë raportuar nga rrethi i Fierit. Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekun e familjes, mjekun infeksionist dhe epidemiolog të rrethit, rastet nuk janë suspekt fruth apo rubeolë por varicelë.

Ethe të Pashpjegueshme


Rastet janë raportuar nga rrethi i Fierit dhe janë pa lidhje epidemiologjike ndërmjet tyre. Në vatër janë marrë masat e kontrollit dhe të parandalimit.

Infeksionet Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme

Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas javëve




Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas Grup-moshave




Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme paraqet rënie në javën e 11-të krahasuar me javën paraardhëse, java e 10-të.

Diarre pa gjak

Trendi në kohë i Diarreve pa Gjak




Shpërndarja e Diarreve pa Gjak sipas Grup-moshave




Trendi në kohë i Diarreve pa gjak paraqet rënie në javën e 11-të krahasuar me javën paraardhëse, java e 10-të.


Trendi i “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 40 – 11 të sezonit 2010-2011 dhe të sezonit 2011-2012. Numri i rasteve.



Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas rretheve në javën e 10-të dhe javën e 11-të të vitit 2011. Incidenca (raste/10.000)




Krahasimi i aktivitetit të “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas sezoneve (javët 40 – 20) dhe Pragu Epidemik. Raste/100.000




Vërehet aktivitet sezonal normal i Infeksioneve Respiratore në javën e 11-të.

**Trendi i “Diarreve pa Gjak” në javët 40 – 11 të sezonit 2010-2011 dhe të sezonit 2011-2012.
Numri i rasteve**



Në javën e 11-të të vitit 2012 numri i rasteve është 28% më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas rretheve në javën e 10-të dhe javën e 11-të të vitit 2011. Incidenca (raste/10.000)



Rastet janë të shpërndara, pa lidhje epidemiologjike ndërmjet tyre dhe nuk janë vërejtur grumbullime.

Kontaktet me epidemiologët e rretheve dhe monitorimi i numrit të personave të paraqitur dhe të shtruar në spital janë në bazë ditore.

Nivelet e Raportimit për javën e 11-të sipas rretheve, në përqindje.

